



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.737/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Afijete Sada Glllogjani , kryesuese e panelit, Burim Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e votuesit Musaj Thaqi, nga Komuna e Glllogocit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.737/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga votuesi Musaj Thaqi nga Komuna e Glllogocit, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga votuesi Musaj Thaqi, nga Komuna e Glllogocit në të cilën pretendon se ai së bashku me familjen e ti të gjerë e kanë votuar kandidatin Perparim Shala, në qendrat e votimit 0317/01R, 0317e/02R, 0317e/03R, 0317e/04D për asamble dhe pretendon se votat e tij dhe familjes se tij nuk janë regjistruar në formular e po ashtu dyshon se personat përgjegjës kane manipuluar me votat e mikut te tij.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se votuesi Musaj Thaqi nga Glllogoci, brenda afatit ligjor ka parashtruar apelin ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimin 0317/01R, 0317e/02R, 0317e/03R, 0317e/04D në Komunën e Glllogocit.

Nga hetimi i PZAP-it i kryer me datën 05.11.2021 në QNR është konstatuar se në vendvotimin e apeluar kandidati Përparim Shala në qendrën e votimit 0317E/04D ka 4 vota dhe numri i votave përputhet me numrin e votave të shënuara për kandidatin nr.5 ne FRK, në vendvotimin 0317E/01R ka 3 vota të vlefshme ndërsa 1 votë të pavlefshme ku është shënuar numri 5 dhe numri 15, po ashtu nga fletëvotimet e pavlefshme konstatohet se në 5 fletëvotime ka qenë i shënuar numri 5 por pa e pasur subjektin, në vendvotimin 0317E/02R ka 2 vota te vlefshme,

ndërsa 6 vota te pavlefshme ku ka qenë i shënuar numri 5 por pa e shënuar subjektin politik ndërsa në vendvotimin 0317E/03R ka 4 vota te vlefshme dhe 1 votë të pavlefshme ku shënohet vetëm numri 5 ndërsa subjekti jo.

Andaj paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.737/2021 më datën 05.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Atijete Sada Glligjani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.